Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Nr. 01/25
Datë: 02.02.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 26.01.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** Kërkesa nr. 01/09 e datës 10.01.2024 e Institucionit "Gjimnazi Britanik për Teknologji" për regjistrim edhe të katër (4) nxënësve për vitin shkollor 2024/2025.

II. Mbetet në fuqi vendimi nr. 01/224 i datës 29.04.2022.

III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij .

A r s y e t i m

Institucioni "Gjimnazi Britanik për Teknologji" me datë 10.01.2024 ka parashtruar në AKK kërkesë për regjistrim edhe të katër (4) nxënësve e cila është protokoluar dhe ka marrë numër 01/09.

AKK me datë 26.01.2024 ka mbajtur mbledhjen e Këshillit Drejtues ku si pikë e rendit të ditës për shqyrtim ka qenë kërkesa si më lartë. Këshilli Drejtues analizoj kërkesën e parashtruar, si dhe vendimin e Këshillit Drejtues nr.01/224 të datës 29.04.2022 me të cilin institucioni "Gjimnazi Britanik për Teknologji" është akreditуar me kualifikimin Teknologji e informacionit niveli IV sipas KKK për periudhën 3 vjeçare sipas të cilit ka të drejtë që të realizoj procesin e arsimit dhe aftësimit me nga 25 nxënës në një klasë. Institucioni i është lejuar që vitin e parë të ketë tre (3) klasa ndërsa dy vitet tjera të akreditimit i lejohet të ketë deri në katër (4) klasa me nga 25

nxënës/kandidatë. Prandaj, KD konstatoj se vendimi nr. 01/224, i datës 29.04.2022 mbetet në fuqi sepse i njëjti është marrë bazuar në raportet vlerësues të ekipit të ekspertëve të cilët kanë vlerësuar se institucioni në kohën e akreditimit ka plotësuar kriteret vetëm për numrin e kandidatëve siç parashihet në vendim, bazuar në kriteret dhe standardet që parashihen në Udhëzimin Administrativ 35/2014 Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Prandaj, si e tillë kërkesa e parashtruar nga institucioni "Gjimnazi Britanik për Teknologji" për regjistrimin edhe të katër nxënësve tjerë për vitin shkollor 2024/2025 refuzohet.

Andaj, siç u theksua më lart Këshilli Drejtues i AKK- së vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i'u dërgohet:

1. Gjimnazit Britanik për Teknologji
2. Arkivit të AKK

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së